



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 28

Datë: 09. 06. 2017, ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi dhe Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Përkthyes: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.
2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor.
3. Aktivitetet e ZRPP-së;
- Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional për ditën e zgjedhjeve.
5. Rekomandim për rritjen e numrit të vëzhguesve në QNR.
6. Të ndryshme.

Vërejtje:

Kjo mbledhje, është mbajtur në Qendren Mediale. Mbledhja, nuk është e regjistruar teknikisht. Pra, nuk ka stenogram. Mungesën e procesverbalit, po e zëvendësojmë me komunikatën nga kjo mbledhje.

Komunikatë

KQZ-ja përmbylli procesin e akreditimit të vëzhguesve: 29 mijë e 264 vëzhgues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbajti mbledhjen e radhës për përgatitjet për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 11 qershor 2017.

Mbledhja u mbajtë në Qendrën Mediale, e cila do të jetë një hapësirë për mediat e akredituara që do të përcjellin punën e KQZ-së.

Në këtë mbledhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve akreditoi Grupin e IX të vëzhguesve dhe të fundit, që do të vëzhgojnë këto zgjedhje. Numri i përgjithshëm i vëzhguesve të akredituar është: 29 mijë e 264 vëzhgues, të ndarë si në vijim:

- 160 vëzhgues nga 8 Ambasada,
- 301 vëzhgues nga 7 Organizata Ndërkombëtare,
- 8 mijë e 830 vëzhgues nga OJQ – Vendore,
- 3 mijë e 657 vëzhgues nga Partitë Politike pjesëmarrëse në këto zgjedhje,
- 15 mijë e 784 vëzhgues nga Koalicionet pjesëmarrëse në këto zgjedhje,
- 27 vëzhgues nga Institucione Ndërkombëtare (Trupa të Menaxhimit të Zgjedhjeve nga vende të ndryshme të botës),
- 1 vëzhgues nga 1 Institucion Vendor,
- 468 vëzhgues të akredituar që përfaqësojnë Media Vendore, dhe
- 36 vëzhgues të akredituar që përfaqësojnë Media Ndërkombëtare.